Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

NEDELNI LIST
FLETORE E PERJAVESHME

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 96 din
— 6 muej 48 —
— 3 muej 24 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 117 | PRISHTINE, 10 Qershuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Randesija e Dekret-ligjit te ri mbi blemjen e detyrueshme dhe kontraktimin e drithnave

Dekret-ligji i ri mbi blemjen e drithnave shprehe rezultatet e zhvillimit t'one ekonomik e politik gjate ketyne tri vjetve, ne te pasqyrohet politika e shtetit ndaj katundaris, politika e ndihmes qe i jep shteti katundaris dhe kooperativizmit. Ket Dekret-ligji do t'a zbatojne keshillat populore qe kane fitue eksperjence te mire ne planifikimin dhe e kane forcue evidencen.

Karakteristika themelore e Dekret-ligjit te ri qendron ne faktin se detyrimet e ekonominave caktohen simbas prodhimit qe nxjere çdo ekonomi. Tepricat e prodhimit caktohen nga keshilli populluer ne kohen kur drithnat piqen. Nga prodhimi i pergjithshem, katundarit i lehen sasinat e nevojshme per ushqimin e familjes, per fare e per bageti, te cilat jane te mjaftueshme. Nga teprica e mbetun caktohet dorzimi i detyrshem simbas shkalles te sasis se siperfaqes te tokes se punueme. Ne ket menyre eliminohet plotesisht çdo tkurresi qe ka ekzistue ne caktimin e normave simbas bektareve dhe rejoneve, sepse detyrimi caktohet ne baze te sasinave qe jane prodhue ne baze te nevojave individuale te bujqeve dhe ne baze te planit shteinuer. Çdo katundarit i lehet edhe teprica e caktueme ne prodhim te lire, e cila lewize prej 90% deri ne 35%, simbas sasis te siperfaqes se punueme.

Dekret-ligji, me te tane sistemin e tij, kujdeset mbi ngritjen e standardit jeteuser te bujkut t'one.

Kete e verteton fakti se çmimi i drithit ne ket vjet asht ma i nalte se ne vjetin e kaluem. P.sh. vjet per 100 kgr. grune paguheshin 330 dinare, e sivjet 412 dinare. Po keshtu qendron edhe me drithnat tjera, te cilat do te blehen me çmimet qe jane perdore deri tash si çmime te lidhuna. Per sasinat e detyrueshme te drithnave nuk do te jepen bona per mallna industrijale. Mirepo, Dekret-ligji jep mundesina ma te gjana qe katundari te furnizohet me mallna industrijale tue i kontraktue drithnat. Kontraktimi asht prioriteti ma i madh qe i jepet katundarit me Dekret-ligjin e ri. Çdo prodhues mund te kontraktoje ma se shumti 6500 kgr. drithna te ndryshem. Lidhja e kontratave fillon me nji here dhe do te zgjase deri ne fillim te mbledhjes se detyrueshme te drithnave. Sasinat e kontraktueme do te llogariten dhe do t'in njifen prodhuesave ne kryemjen e dorzimit te detyruesbem. Veç kesaj, prodhuesi i shet kasinat e kontraktueme 25% ma shtrej te se sasinat te cilat jane te detyrueshme dhe ma shtrejte se ato qe do te mblidhen ma vone lirisht. Ne ket menyre, u sigurohet te gjithe prodhuesave qe deri ne sasin prej 6500 kgr. te fitojne çmimin 25% ma te madh dhe per gjithe ket shum te fitojne bona per mallna industrijale, tue iu njofte njikohesisht kjo sasi e kontraktueme si dorzim i detyruesbem. Sipermarrjet e blemjes do te japin per sasinat e kontraktueme 40% te te hollave dhe te bonave si parapagim, e sasinat tjera te pareve e bonave do te jepen me rastin e dorzimit te drithit. Kooperativat bujqesore te punes mund te lidhin kontrata per te gjitha tepricat e tyne, don me thane ne ma se 6500 kgr.

Siç shihet, fitimi ma i madh i katundarit dhe detyra ma e madhe qe gjindet para pushtetit populluer, para sipermarrjeve te blemjes dhe para kooperativave asht organizimi dhe kryemja e planit te kontraktimit. Nga spjegimi i drejte i te gjitha prioriteteve te kontraktimit per katundarin t'one, nga organizimi i lidhjes se kontratave mvaret ne se bujqet t'one do t'i çfrytezojne ne mase te plote dobite e mdhaja qe ua jep ky Dekret-ligje. Sistemi i kontraktimit ia ban te mundeshem bujkut me i perdore ne dobin e vet prodhimet e tija, me u-furnizue me mallna industrijale dhe me marre parapagim.

Organizimit te lidhjes se kontratave dhe mbledhjes se tepricave te drithnave duhet me u kushtue kujdesin ma te madh.

Duhet me ia spjegue çdo prodhuesit prioritetet e kontraktimit, e keshtu çdonjeni te kontraktoje sasina sa ma te mdhaja. Per nji akcjon kaq te madh duhet me i perdore kooperativat t'ona, te cilat neper çdo katund duhet t'a organizojne aktivin e gjane qe ka me qene ne gjendje me perfshi çdo prodhues. Nuk duhet lejue qe kontraktimi t'i lehet stihis dhe te kryhet ne zyra.

Çdo stacjon duhet t'a kete planin opqrativ te detyrave te dites, çdo njeriut duhet me ia caktue detyrat konkrete. Per zbatimin e kontraktimit duhet t'angazhohen ne mase te plote organizatat t'ona masovike: Fronti Populluer, Fagu, Rinija Popullore dhe Sindikatat. Nga antaret e ketyne organizatave me sigurue agitatoret, te cilet do te bashkepunojne dhe agitojne per plotsimin e planit ne tanesi.

Ja se çka ban angazhimi i organizatave masovike dhe i pushtetit: Lidhja e kontratave shkon ma se miri ne rrethin e Prishtines: deri tash jane kontraktue 364.080 kgr. drithna te bardha e 61.200 kgr. miser. Ky rreth u ka shpalle gara te gjitha rretheve tjera se kush do te kontraktoje sa ma shum e sa ma pare drithna. Ne ket rreth normat e dites jane tejkalue. Ne rrethin e Drenices deri tash jane kontraktue 36.700 kgr. drithna te bardha dhe 18.705 kgr. miser; ne rrethin e Lipjanit ma se 118.890 kgr. drithna te bardha dhe ma se 17.550 kgr. miser; ne rrethin e Vuçiternes — 14.750 kgr. drithna te bardha dhe disa sasina misri; ne rrethin e Prizrenit 6.000 kgr. miser dhe 9.855 kgr. drithna te bardha; rrethi i Rahovecit 17.550 kgr. drithna te bardha. Kontrahimi vazhdon ne mbare Krahinen.

Ket vjet, mbledhjen e drithit do t'a kryejme ma lehte sepse kemi ma shum maqina fshise dhe aty per aty do te merren drithnat e te jepen te hollat e bonat perkatese.

Duhet me u-kujdesue mbi llojet e drithnave.

Derisa ne vjetin e kaluem drithnat rrijshin neper lokale te dobta dhe zejshin shkolla e vende tjera, shpesh here edhe rrijshin jashte, sivjet kemi shum magazina te reja, por edhe nuk jane te mjaftueshme, prandaj duhet me ba çmos qe sa ma pare te cimentohen lokalet qe i jep pushteti, per t'a ruejte drithin prej mijve, prej zogjve; sa ma pare te sigurohen koshat qe ende nuk jane gadi, te sigurohen magazinat dhe te zbatohet akcjoni masovik.

Thaset, çadrat e ambalazhi tjeter duhet te jene te sigurueme e t'arrnueme qysh tash. Ne çdo pikepamje te zhvillohet nji lufte e ashper per kursim sa ma te madh.

Ne te tane Krahinen t'one njerzit punonjes po zhvillojne gara per ndere te Kongresit te V te PKJ

Si ne mbare Jugosllavin, ashtu edhe ne Kosmet, puntoret dhe bujqit t'one pranojne dhe shpallin gara per ndere te Kongresit te V-te te Partis komuniste te Jugosllavis. Ata e dijne se kjo asht menyra ma e mire per t'i shprehe mirenjohjen ma te thelle Partis se lavdishme komuniste per sakrificat dhe perpjekjet vigane ne lufte e ne paqe si avangarde e klases puntore.

Minatoret e Trepçes u shpallin gara te gjithe minatoreve te Jugosllavis. Veç detyrimeve qe ka marre kolektivi punonjes i Trepçes per ndere te Kongresit te V-te, puntoret e minjeres Stari Trg kane marre zotime individuale e grupesh, tue zhvillue gara ndermjet vedit. Keshtu, puntoret e horizontit 545 u shpallen gara puntorve te horizonteve tjera, tue u-zotue se deri me 21 korrik planin vjetuer te prodhimit per çdo dite do t'a tejkalojne me nga 15%. Detyrime te ketilla kane marre edhe puntoret e tlegve te tjera.

Per ndere te Kongresit te V-te te Partis komuniste te Jugosllavis, Drejtorija e rrethit te Prishtines per ndertimin e shtepijave kooperative u shpalle gara te gjitha drejtorive te rretheve ne Krahinen t'one se kush e ndertoi e para nji shtepi kooperative deri ne diten e Kongresit, kush e mbaron muratimin e kater shtepijave, kush e kryen deri ne dritore muratimin e te gjitha shtepijave, etj.

Edhe Bashkimi kooperativ i rrethit te Prishtines fton ne gara te gjitha bashkimet e rretheve se kush do t'a kryej ma mire planin e punes deri ne diten e Kongresit.

Rinija e Krahines t'one, e cila punon nder akcjonet krahinore e lokale, i ka prite me entuzjazem te gjitha ftesat per gara dhe i zhvillon keto ne mes te brigadave, çetave dhe individeve.

Rinija e Kosmetit n'akcjon

Ndermjet Beogradit e Zemunit, ne bregun e majt te Saves legjendare, brigadat puntore te rinis popullore te Jugosllavis ndertojne kryeqytetin e atdheut t'one-krenarin e ndertimit socjalist-Beogradin e ri. Lufta triumfuese çlirimtare e popujve t'one kundra okupatorve fashista-lufta ma legjendare qe njef historija e popujve te Jugosllavis-ka fitue bazat e saja bash ne Beograd. Aty Komiteti Qendruer i Partis Komuniste te Jugosllavis me shokun Tito ne krye, vuni bazat organizative te luftes çlirimtare. Sot, syt e te gjithe njerzve te mundit drejtohen kah Beogradi, prej ku mesuesi i jone, organizatori dhe inicjatori i te gjitha fitoreve t'ona, shoku Tito, drejton ndertimin gjigant te shoqnis socjaliste. Sot, pra, Beogradi legjendar asht qendra politike, ekonomike e kulturore e Jugosllavis. Tue qene i tille, vetvetiu u-paraqit nevoja qe, krahas me shoqnin e re socjaliste qe po krijohet, te ndertohet edhe Beogradi i ri socjalist, te ndertohet qendra e denje socjaliste ne bazen ma moderne, simbas fjales se fundit t'urbanizmit. Pra, kushtet ekonomiko-politike ne Vendin t'one, ndertimi me plan-ritmi i shpejt i industrijalizimit dhe elektrifikimit te Vendit t'one, rritja e turrshme e nevojave kulturore te popujve t'one e kerkuen ndertimin e Beogradit te madh, kryeqytetit te Republikes Federative Popullore te Jugosllavis.

Herojt e Vrandukut, qe me djersen e krahun e tyne luftuen per çdo pllambe toke te paperkulshme te Bosnjes trime, prej Shamacit ne Sarajeve, ata djem e vajza qe ne fushen e lame te Zheleznikut ndertuen bazen e industris s'one, ata djem qe me krahnorin e tyne po bajne mrekullina ne pune per lulzimin e Vendit t'one, si p. sh. luftetaret e Landovices qe transformuen male te thata ne vneshta e pemishte madheshtore, ata sot po çelin themelet e Beogradit te ri, bash ne kandin ku dy lumejt legjendare bashkojne ujin e tyne. Aty, pranë Saves e Danubit, ku hitlerjanet kriminela ndertuen therrtoren e njerzve perparimtare-llogorin e vdekjes-dhe me thiken e plumbin e tyne varrosen me mija djem e vajza te popujve t'one, aty sot djersa e te rijve trima po perzihet me gjakun e deshmorve te rame per ngritjen e lumtunis se njerzve t'one,-per realizimin e idealit t'atyne qe flijuen jeten aty dhe ne te gjitha anet e Vendit t'one, idealit t'atyne qe sot po derdhin djersen e ballit aty dhe ne te gjitha anet e Vendit t'one. Ne ket akcjon te madh te rinis se vllaznueme heroike te Jugosllavis, Brigada e pare e Kosmetit, e perbame prej rinis shqiptare, serbe e malazeze te Krahines s'one, ia zbardhi faqen Krahines s'one-fitoi flamurin kalimtar dhe u-shpall sulmuese. Tri Brigadat e Kosmetit me 787 te ri e te reja punojne me hovin ma te madh, per t'i krye detyrat qe u jane besue si te ri te barabarte ne Jugosllavin e Titos.

Jo larg tyne, fillon kolona tjeter e rinis e perhapun ne ma se 120 km.— jane dheta mija te ri e te reja te te gjitha aneve te Jugosllavis, ne mes te cilve pese Brigadat e Kosmetit me 1387 te ri e te reja, te cilet luftojne per ndertimin e autostrades "Vllaznimi e Bashkimi". Vet hovi dhe perpjekjet e rinis e tregojne randesin qe ka kjo rruge per popujt e Jugosllavis. Me ane te kesaj rruge moderne bashkohen dy qendrat ma te mdhaja e ma te randesishme te Vendit t'one-kryeqyteti i Jugosllavis, Beogradi, me kryeqytetin e Kroacis, Zagrebin. Bashkon dhe lidhe akoma ma ngusht politikisht, ekonomikisht e kulturalisht Serbin me Kroacin, e nepermjet te ketyne bashkohen vendet ma te largeta te Jugut te Vendit t'one me viset ma verjore te Slloveneve vllazen. Nga ana tjeter, kjo autostrade kapet me rrugen internacjonale dhe lidhe Zagrebin madheshtor me vendet e demokracis popullore deri ne qendren e lulzimit botnuer-deri ne Mosken bolshevike. Asht per t'u vue ne dukje edhe nji karakteristike tjeter, te cilen e tregon vet emni i rruges: me ane te punes dhe jetes se perbashket te rinis s'one, ne ket rruge thellohet me vepra vllaznimi e bashkimi i popujve t'one. Aty, ne rrugen shum pak ma te gjate se vija ajrore qe lidhe keto dy qendra te Vendit t'one, serbi e kroati, slloveni e maqedoni, boshnjaku, malazezi e shqiptari etj. tuttojne bashke se kush t'a kaloje ma teper normen ne pune, kush te mesoje ma shum, kush te zhvilloje trupin e vet ma mire. Me garat qe bajne ndermjet vedit dhe me rinin n'akcjonet tjera, ata i çfaqin PK e shokut Tito mirenjohjen ma te thelle. Se sa mirenjohtese i asht rinija e jone shokut Tito, Partis Komuniste, Planit pesvjeçar, kete e tregon vet fakti se Brigada e Pare e Kosmetit ne rrugen "Vllaznimi e Bashkimi" asht shpalle sulmuese.

Grupe me 500 te rijsh e te rejash punojne njena mbas tjetres edhe ne Krahinen t'one.

Ma se 350 te ri e te reja nga rrethi i Lipjanit e Vuçiternes po ndertojne rrugen Kuqishte—Boge. Pyjte e denduna te Rogoves kurre nuk jane çfrytezue nga populli, kurre nuk i kane sherbye popullit, por jane djege, jane rrahe me shekuj nga atmosfera e ashper e bjeshkve te Rogoves, ose çfrytezue prej ndonji kapitalisti te pangopun te Vendit t'one, ose me levoret e gjethet e tyne kane ushqye egersinat e malit dhe dhite e Rugoves, Boges, Kuqishtes e katundeve tjera. E sot, 350 te ri e te reja te cilet jane zotue se, per hire te lumnis e mireqenjes se popujve t'one do te ndertojne tete kilometra e gjysem rruge para afatit te caktuem, ata i sigurojne industris s'one te drunit landen e pare, mija te rijve e frontistave qe punojne ne ndertimin e shtepijave kooperative u a sigurojne landet e drunit per t'a krye edhe ata para afatit detyren qe kane marre persiper. Keta te ri deri tash kane dhane ma teper se 6797 dite pune vullnetare.

Ma se 400 te ri tjere sot punojne pa pra ne rrugen Deçan—Gilloxhan ia teshojne fshatit ne çfrytezim ahishtet e mrekullueshme te bjeshkve te Gilloxhanit, u sigurojne pune mija katundarve qe deri me sot jetojshin me nji kafshore buke e krype, sigurojne lande per industrin t'one te drunit.

Beogradi i ri, autostrada "Vllaznimi e Bashkimi", fabrika „Ivo Ribar Lola" hekurudha Kuçevo—Brodice, rruga Kuqishte—Boge, rruga Deçan—Gilloxhan, zgjanimi i vneshtave te rinis se Landovice, me qinda shtepija kooperative ne Krahinen t'one — jane nji front shum i gjane pune, ku rinija e Kosmetit punon me mish e shpirte e veledijshme se krijon lumnin per vehten, per popujt t'one, per brezat e ardhshme.

Gj. L.

Mekanizimi i bujqesis asht kushti i domosdoshem per kryemjen e detyrave qe shtron Plani pesvjeçar

Detyra e pare e organizatave te Frontit ne katund asht angazhimi i per gjitheshem per afresimin dhe perparimin e kooperativizmit. "Ne qofte se na kooperativat t'ona, nuk i bajme nji qender te forte ekonomike ne katund, qe, perveç furnizimit te katundit me artikujt industrijale dhe blemjes se prodhimeve bujqesore per t'ia shite tregut te jashtem, t'angazhohen ne perparimin e vete ekonomis dhe krijimin e punuve kooperative (parkut te maqinave, stacjoneve te seleksjonimit etj.), t'angazhohen per zbatimin e metodave moderne shkencore ne bujqesi etj.-shtepijat kooperative do te bahen nji trup i pa shpirte, do te shndrrohen ne qendra te zyrtarit per mbledhje politike e kulturore". (B. Neshkoviq). Dhe me te vertete rezultatet qe ka korre bujqesija e jone deri tash kane tregue se kjo asht bakur mbrapa industris dhe se gjendja e soçme e prodhimit bujqesuer nuk mundet me i plotesue te gjitha nevojat e shtimit t'industris. Prandaj, zhvillimi i industris kerkon pa tjeter ngritjen e prodhimit bujqesuer. E, per t'a ngrite ket, pike se pari duhet t'a zhdukim mbrapambetesin ne bujqesi, t'i veme ne zbatim te gjitha masat agroteknike, t'i perdorim metodat shkencore.

Mekanizimi i bujqesis asht kushti i pare dhe i domosdoshem per kryemjen e detyrave te medhaja qe shtron Plani pesvjeçar. Sot katundarija e jone ka mundesina mjaft te medhaja per perparimin e bujqesis. Ne rend te pare industrija e jone po prodhon almise ma te mira, maqina te ndryshme bujqesore plehna artificijale etj. Te gjitha keto prodhime t'industris s'one i jepen katundarit nen kushte shum te mira e te lehta; i blene me çmimet e lidhuna.

Kooperativat bujqesore te punes dhe kooperativat shit-blemse ka mundesi me te zojat me zbatue çdo mase agroteknike dhe me sigurue çdo mjet e maqine,-sepse "struktura e bujqesis s'ime private e kufizon mjaft zbatimin e masave agroteknike dhe mekanizimin e bujqesis" (Kardelj) dhe nuk asht ne gjendje materjale me i sigurue te gjitha mjetet e maqinat,-gjinden para shum e shum detyrave te rande-fshme.

Nji nga detyrat ma te randesishme per kooperativat bujqesore te punes asht kjo: me hape puntorina te ndryshme per meremetimin e almiseve te ndryshme bujqesore, per perparimin e prodhimeve bujqesore. Stacjonet t'ona bujqesore te maqinave tash per tash punojne ne shumice token e pasunive bujqesore te shtetit dhe te kooperativave bujqesore te punes. Per t'ia sigurue masave t'ona te gjana bujqesore punimin e tokes me maqina dhe perdorimin e te gjitha masave agroteknike, veç stacjoneve te maqinave dhe pasunive bujqesore te shtetit, mika me te madhe mund t'apin edhe kooperativat bujqesore, tue formue seksjonet e tyne te maqinave dhe puntorinat e ndryshme. Nga ana tjeter, kooperativat shit-blemse katundare kane per detyre me formue seksjonet e tyne te maqinave per t'ia sigurue bujkut sa ma teper punimin e kulturuem te tokes. Duhet te perpiqen me porosite te gjitha almiset dhe maqinat e nevojshme.

Zhvillimi i industris ne katund asht po ashtu nji nga kushtet e domosdoshme per industrijalizimin e bujqesis.

Ne Krahinen t'one egzistojne te gjitha kushtet per zhvillimin e industris lokale nga kooperativat. Kete e vertetun fakti se disa kooperativa si p.sh. e Llapiesalles, Cagllavices, Vrelles, Devet —Jugoviqit, Dobreves e Orllovqit, kane marrje me hape puntorinat e zdrukthtaris, qerreve dhe farkdoret. Keto i çfrytezojne mjetet lokale per prodhimin e tyne: hekurin e vjeter, drunin etj.

Fillimi i punes ne keto puntorina ka qene mjaft i veshtire per mungese te mjeteve dhe mjeshtrave. Por, ne saje te perpjekjeve te kooperativistave dhe ndihmes se Drejtoratit te Bujqesis e Pyjeve prane Keshillit Krahinuer, sot shumica e puntorinave disponon sasina te medhaja mjetesh e maqinash. P.sh. puntorija ne Llapiesalle ka fitue maqinen-bor, burginat e te gjitha dimensjoneve dhe maqinen per ndrydhjen e hekurit. Kooperativistat e Dobreves kane sjelle nga Vojvodina nji motorr me sharren e hekurit, tre drebanga e kater pale vegla komplete zdrukthtarije e per punimin e qerreve. Tue çfrytezue hekurin e vjeter, zejtaret kooperativista t'Orllovqit kane ndreqe te tana veglat per nji puntori te mekanizueme. Kooperativisti Luko Steviq, prej Cagllavices, nga burimet lokale ka ndreqe nji mulli. Ne krahasim me gjendjen e perparshme, kur keto puntorina kishin vetem nga nji mjeshter autodidakt dhe disponojshin vetem almise t'imta, sot veprimtarija e tyne asht shum e zgjanueme dhe mekanika mjaft e gjone. Ne keto puntorina punon nji numer mjaft i madh puntoresh. Paraqitet nevoja qe ne keto puntorina te pranohen nxanes te cilet te mesojne zanatin.

Ne keto puntorina, perveç meremetimit t'almiseve e te maqinave punohen edhe mobilje, kaca, fuçina e qerre. Kooperativistat e Orllovqit kane hape ne puntorine e tyne edhe degen e zdrukthtaris, ne lidhje me nevojat e ndertimit te shtepis kooperative, e ata te Llapiesalles e kane punue te tane mobiljen per kooperativen shit-blemse. Ne farkatoren e Dobreves kooperativistat mbrenda kater ditve prodhojne nji karroce. Te gjitha kooperativat bujqesore te rrethit te Prishtines e Lipjanit kane porosite qerre ne ket puntori. Tash ne keto puntorina jane tue u-meremetue almise dhe maqinat bujqesore per korrje e fshimje.

Vlene me permende se ne shum vende ekzistojne kushte per zhvillimin e degve tjera t'ekonomis lokale: perpunimi i qumshtit, rritja e bletve, krymbit te mendafshit e shpendive etj. Diku edhe jane marre masa per keto dege t'ekonomis, p. sh. jane vue bagreme per rritjen e bletve, jane çele kurse (ne Deçan) per rritjen e shpendive dhe bletve.

Per realizimin e ketyne detyreve, organizata e Frontit dhe pushteti popullor duhet t'apin ndihmen ma te madhe dhe te bajne gmos per zbatimin e detyrave qe shtron ne lidhje me kete Kongresi i Dyte i Frontit Popullor.

Punimi i pelhurnave ne Prizren

Ka disa muej qe ne Prizren ka marre nji hov te madh punimi i pelhurnave prej bytymbykut dhe mendafshit artificjal. Me kete lloj pune merren 90 shqiptare, te cilat punojne nder vekna neper shtepijat e veta. Pelhurat punohen me kujdes dhe ne kualitetet shum te mira. Keto i shet granapi jo vetem ne Krahinen t'one, por edhe ne pjesen tjeter te Serbis, e ma teper ne Bosne e Hercegovine, ne te cilat bahen kmishe grash, çarshafa dyshekesh, perde, mbulesa tavolinash etj. Femnat qe merren me kete pune paguhen mire dhe ne dy kate-gori pune. Edhe ne ket sektor ngjane qe disa gra t'i çfrytezojne disa te tjera, gja e cila ban qe te lkundohet puntorja e vertete. Tue i marre parasyshe te gjitha keto, duhet qe organizata e Frontit ne qytet te perpiqet me i bashkue te gjitha grat ne kooperative te veçante per femna, deri ne kete menyre atyne do t'u interesoje edhe ma teper, se parit, sepse do te garantohen si puntore dhe, se dyti, do te kene kushte ma te mira pune. N'anen tjeter, granapi duhet t'i sigurojë mjetet e punes, vendin e per shtatshum etj.

Luftetaret per prodhim ma te madh

Kooperativa bujqesore „Crvena Zvezda" i fton ne gara te gjitha kooperativat

DOBREVE:

Te gjithe njerzit e mundit ne Jugosllavin e te perpiqen me te gjitha fuqit per prodhim sa ma te madh e sa ma te mire n'interes te ngritjes se standardit jetesuer te masave te gjana popullore. As bujqit e Kosmetit nuk mbesin mbrapa ne ket pikepamje.

Kooperativistat e kooperatives bujqesore te punes "Crvena Zvezda" ne Dobreve, edhe sivjet i kane mobilizue te gjitha forcat per shtimin sa ma te madh te prodhimit. Vjet, kete ne saje te perpjekjeve te tyne kane zane vendin e trete ne Republiken Popullore te Serbis.

Plani financjar i prodhimit asht aprovue dhe kane fillue garat. Komisjoni per dhanjen e flamurit kalimtar kontrollon per dite kualitetin dhe sasin e punes. Cdo grup e ka te caktuem hektarin e punes dhe lufton per prodhim sa ma te madh. Jane caktue edhe shperblimet per ate grup ase ate individ, prej tokes se te cilit te nxjerret ma se shumti prodhim. Grupi i trete i brigades se dyte, te cilin e drejton Mirko Shupiq, per here te dyte e mban flamurin kalimtar. Ky grup qysh heret, ne te zbardhunit e drites punon pa pra. Punojne edhe naten. Si vllaçitsat ma te mire jane shque Rexhep Emini e Milivoje Grujiq, e Dushan Kesiq, luftetar i famshem per prodhimin ma te madh, dy here me rradhe i ka vllaçite drithnat dimnore. N'aren qe e punon ai, jane sjelle 500 qerre plehi shtatit dhe 200 kgr. pleh artificjal. Perpara, ne ket are nuk mbillej kurgja. Sot, drithnat e kesaj are kane pe parun shum ma mire se n'arat e kooperativistave tjere.

Kooperativistat e kooperatives bujqesore "Crvena Zvezda" i kane ftue ne gara te gjitha kooperativat e Krahines s'one. Garat zhvillohen me ho t'i ma te madh: kush do t'a realizoje ma pare dhe ma mire planin e vet financjar te prodhimit, dhe te korre ma teper fryte nga pasunit e veta.

Sadri Ademi — luftetar i shquem per prodhim ma te madh

VUÇITERNE:

Edhe rrethi i Vuçiternes ka luftetare te shquem per prodhim ma te madh. Nji nder ma te mire', asht Sadri Ademi, nga Oshlani. Qe se çka thote Sadrija.. "Kam ndi prej frontistave dhe puntoreve se duhet me e punue token ma mire per me dhane fryt ma te mire. Edhe une u-gezova kur me thane se prej dy hektarve e gjise te tokes se dobet t'Oshlanit, te cilen une e kam, do te mund te nxjerre fryt ma te mire e ma shum. Por, me e thane te drejten, nuk besojshem shum ne ket gja. Fillova me punue simbas udhezimeve qe me dhane ekspertat: arat i plehnova mire dhe i lavrova thelle, e plehnova mire faren dhe e mbjella i pari ne katund. Tash gjithmone kujdesem per rritjen e tyne".

Sadri Ademi asht i njoftun si luftetar per prodhim te madh. Fqijt e tij jane çudite kur vjet kane pa me syt e tyne se si prej nji hektarit toke deri vone te papjelleshme ka marrje me nxjerre 1300 kilogram grure. "Sivjet, thote Sadrija do te nxjere shum ma teper se vjet".

Sadrija i mban mire edhe bagtit. Tue i ushqye lopet me terfoje, ai ka arritje me shtue tamblin lopve 50%. Lopet e tij japin sot nga 12-13 litra tambel ne dite.

Edhe kopshtin i mban shum bukur: rreth shtepis se tij ka mbjelle trupa mollash, dardhash, pjeshkash, e ne kopsht ka shartue trandafila te bukura. Ka ndigjue se tue i shartue kumbullat me pjeshke, fitohet nji lloj shum i mire kumbullash, e edhe ket gja e ka ba. I pari ne katund i ka pastrue pemet prej krymbave, i pari e ka mihe dhe mbjelle bashçen e tij. "Asht knaqesi e madhe me e pa shtepin, kopshtin, arat dhe gjate e tij"-thone katundaret e Oshlanit.

Vetem puna ma e mire dhe intensive e siguron fitimin ma te madh ne prodhimin, prandaj bujku Sadri Ademi asht shembull i mire per te gjithe bujqet e Krahines s'one.

Korrjet po afrohen prandaj duhet me u-pregatite

Ne te tane Krahinen t'one kane fillue pregatitjet per korrje e fshimje. Stacjonet e maqinave ne Kosmet po i meremetojne maqinat e nevojshme. Suksesin ma te mire deri tash e ka korre stacjoni maqino-bujqesuer ne Prishtine, i cili qysh ne gjysem e dyte te muejit maj ka krye meremetimin e te gjitha maqinave fshijse, fshijseve te dores dhe maqinave te korrjes. Ma se 53,4% te traktorave jane ne pregull, ndersa 23,4 gjinden ne meremetime ne Novi Sad, dhe deri me 1 korrik do te jene gadi, e 23,2% jane tue u-ndreqe ne stacjon.

Stacjoni maqino-bujqesuer ne Peje ka krye meremetimin e fshijseve automatike 80%, fshijseve te dores 60%, maqinave korrese 66,6% dhe trypave 19.4%. Te gjithe motorrat jane ne gjendje te mire.

Stacjoni maqino-bujqesuer ne Ferizaj i ka ndreqe te gjitha fshijset automatike, ndersa meremetimi i fshijseve te dores posa ka fillue, shtate traktora te ketij stacjoni jane dergue per meremetim ne Nish dhe do te jene gadi deri me 20 te ketij muej. Ma se 35% traktora qe gjinden ne stacjon, jane meremetue. Kolektivi puntuer asht zotue se traktorat do t'i meremetoje deri me 15 qershuer.

Stacjoni maqino bujqesuer i Vuçiternes po ashtu po i meremeton te gjitha maqinat e diftuna per korrje dhe fshimje. Gjinden per meremetim ne Nish 14 traktora dhe deri me 20 te ketij muejit do te kryhen dhe te vehen ne perdorim. Deri me 20 qershuer te k. v. do te meremetohen edhe 10 fshijse automatike dhe 25 maqina fshijse. Meremetimet e maqinave tjera vazhdojne.

Asht hape nji kurs per perdorimin e fshijseve automatike.

Edhe pronaret privat tash i kane te sigurueme kushtet per gjetjen e materjalit per meremetimin e maqinave. Korrja dhe fshimja e ketij vjetit do te kryhet shum ma mire e ma ne rregull se ne vjetin e kaluem. Korrja dhe fshimja e rregullt siguron nga ana tjeter edhe mbledhjen e shpejte te tepricave te detyrueshme dhe te kontraktueme te drithnave.

Nga ekonomija lokale ne Prizren

Me punimin e leshit — femnat e Prizrenit sigurojne ekonomin e familjeve te veta

Femnat e Prizrenit po merren gjithnji me punimin e leshit ne shemperia, kostume, çorape, geta etj. Me punen e tyne gjate vitit 1947, ato nuk mundejshin me sigurue veç nji fitimi te vogel, mbasi leshi shitej me çmimet shum te nalta ne tregun e zi. Per kete arsye interesimi i punimeve te leshit nuk ishte edhe aq i knaqshem.

Keshilli i qytetit dhe granapi tue pa se nji pune e kesaj ishte e pahrishme dhe e rande si per bierait ashtu edhe per shitesit, ndermorren me ndermjetsue prane Ministris s'Industris qe ajo te caktonte nji sasi te konsiderueshme leshit per punimin e tij ne qytetin e Prizrenit. Ne fruer te ketij vjeti, mbasi Ministrija ne fjale caktoi nji sasi te mjaftueshme leshi, granapi e hapi kooperativen, ne te cilen edhe sot marrin pjese 61 gra e vajza, prej te cilave 27 shqiptare.

Grat e vajzat, si shqiptaret ashtu edhe serbet, punojne 8 ore ne dite, keshtu qe u mbetet kohe me krye edhe disa prej puneve nder shtepija e tyne. Ato paguhen simbas punes qe bajn sejcila: kush prodhon ma shum, shperblehet ma mire. Te gjitha i gezojne te drejtat si puntoret e çdo sektori tjeter: furnizohen me ushqim e veshmbathje dhe jane te garantueme ne sigurimin shoqnuer, gezojne te drejten e pushimit vjetuer etj. Dicipjina e tyne ne pune asht shembullore dhe puna mjaft e mire.

Puna e dores se tyne kryhet simbas sezones dhe simbas kerkeses se sipermarrjeve, me te cilat granapi ka lidhe kontrate jo vetem mbrenda Krahines, por edhe ne pjesen tjeter te Serbis e jashte saj. Kualiteti i punes asht shum i mire, çmimi mjaft i arsyeshem, derisa tash çdo pune e dores prej leshit kushton 50% ma lire se ne vjetin e kaluem.

Pergjegjeset e kesaj kooperative: Vera Arsiq dhe Kosara Stojkoviq interesohen mjaft per punen kolektive dhe per permirsimin e kushteve te puntoreve. Keto te dyja merren edhe me ngjyrmjen e leshit. Tremben se per se shpejti kane me ju mungue bojnat e ndryshme, gja e cila ka me shkaktue nderpremje pune etj. Ne lidhje me ket asht shum e nevojshme qe granapi t'interesohet me i gjete bojnat aq sa nevojiten dhe simbas llojeve qe kerkohen: te kaltert, blu, boje hiri, boje ujku, te kuqe te gekl, te zeze etj.

Lokali ku asht vendose kooperativa e puntoreve, nuk asht aspak i pershtatshem, mbasi ato nuk e kane komoditetin e nevojshem, si karrika, shtrese per vend-ndenje, kurse ato jane te detyrueme me punue per dhe ase ndi disa shtroje qe ato i kane sjelle prej shtepijave te veta. Per komoditetin e puntoreve ne pune, jo vetem qe duhet t'interesohet granapi, por edhe pushteti i vendit, organizata e Frontit, sindikata etj. Duket se tash ne fundi asht ndermarre diçka per gjetjen e nji ndertese ma te pershtateshme per ket kooperative, keshtu qe do te permbushet njena prej kondittave ma kryesore te puntoreve.

Nder puntoret dallohen ma te mira ne pune e dicipline: Hidije Abdullah, Rabia Bozhdiq, Manika Petroviq, Mileva Ajtiq, Brana Kujungjiq, Dushka Deliq, Dobrila Nedeljkoviq, Dushka Dekiq, Naile Myrteza, Nada Nikoliq, Lepka Svetkoviq, Vera Svetkoviq dhe Jelka Milloshoviq. Te gjitha keto punojne ma shpejte dhe ne kualitet ma te mire se te tjerat, me gjith qe edhe ato punojne mjaft mire dhe dite per dite perfeksjonohen ne kete profesjon sa ma mire.

Perveç kesaj kooperative, me kete pune merren edhe 411 familje shqiptare e serbe, te cilat punojne neper shtepijat e veta. Asht mire qe keshilli i qytetit dhe granapi te perpiqen me e shtue numrin e puntoreve ne kete kooperative, mbasi ne kete menyre ajo te permirsohet dhe do te garantohet jeta e puntoreve dhe do te zhduket çfrytezimi i punes se njenes ne kurriz te tjetres, mbasi disa prej tyne po u bahkan punedhanese te dyta. Ne kete rast atyne te kesaj kategorije asht e nevojshme dhe e domosdoshme qe granapi te mos u jape material po qe se nuk e punojne ato vete.

Siç shifet pra, nepermjet te ketij sektori t'ekonomis lokale, nji pjese te mire e femnave te qytetit e sigurojne dhe e permirsojne ekonomin e familjeve te tyne, prandaj duhet qe dite per dite te rritet kooperativa te permirsohen kushtet e punes, te shtohet hovi i prodhimit ne pune dhe te perfeksjonohet sa ma mire kualiteti i prodhimit.

K. D.

ARSIM E KULTURE

Vazhdimi i likuidimit t'analfabetizmit gjate pushimeve verore ne Krahinen t'one

Nder disa qytete, katunde dhe sipermarrje te ndryshme te Krahines s'one nuk asht nderpre puna e kurseve analfabetike dhe e atyne arsimore, por nuk mjafton me kaq. Asht e nevojshme qe aksjoni i luftimit t'analfabetizmit t'a vazhdoje punen e vet ne çdo vend te Krahines s'one edhe gjate muejve te pushimeve te shkollave. Ma gjithe qe mesuest do t'a çfrytezojne pushimin vjetuer gjate veres, edhe pse nuk do te jene prane kurseve, prap se prap kudo gjinden kuadra te rijsh, te cilet mund t'i udheheqin kurset ma se miri. Keshtu per mashkuj e per femna, per puntore, katundare e qytetare, te ri e te reja. Nuk duhet te çuditemi ne se deri tash nuk e kemi praktikue ket pune edhe gjate veres. Duhet te kemi parasysh qe t'arrijme dhe te tejkalojme planin ne gjithe Krahinen t'one, ashtu siç asht parapa-i ndame nder kumbesina dhe sekse.

Nder keto kurse duhet te marrin pjese perveç atyne qe nuk kane qene kursista te rregullt gjate muejve te kaluem, edhe ata te cilet nuk jane parqite ne provimet e fundit-mashkujt e femnat. Puntoret qe gjate dimnit kane qene te shperndame nder katunde e qe tash kane fillue te punojne neper sipermarrjet e ndertimit dhe te tjeret kudo qofshin, kane kondita te mira per te mesue edhe gjate ketyne muajve, deri sa punojne e jetojne ne kolektivitet. Po keshtu, n'anen tjeter, edhe femnat i kane te njajtat kushte e mjaft kohe per te mesue dhe per vende mesimi lokalet e shkollave. Ato do te kene mjaft kohe me i krye ti punat n shtepis, me u-kujdesue per rritjen e femijve te tyne dhe nji pjese te kohes me e sakrifikue qe te mesojne shkrimin e kendimin, derisa ditet e veres jane mjaft te gjata.

Tash vjen rradha te kurset amimore. Edhe nder keto duhet qe kursistat dhe kursistet, te cilet kane fitue nder provime, te mesojne sa ma shum, ne menyre qe mos t'a harrojne alfabetin, siç ka ngja aty ketu, por perkundrazi t'aftesohen derisa e kane konditen ma kryesore-shkrimin e kendimin.

Se si punohet nder kurset analfabetike edhe gjate fazes se dyte te kesaj fushate mbrenda ketij vjeti, perveç te tjerve, kallxon iniciativa e katundares Arife Qelabija, e cila udheheqe nji kurs grash ne katundin e vet, Sellograzhde, dhe qe vet aja ka mesue te shkruej e te kendoj ne kursin analfabetik te vjetit te kaluem; po keshtu ne te njajtin katund kursin prej 33 analfabetesh, e udheheqe ma se miri i ziu Ded Luka. Kursi qe udhehiqet prej puntorit Lut Bajrami prej Gjakove ka si kursista te rregullt 50 puntore te sipermarrjeve te ndertimeve.

Gara ne mes te shkollave fillore te rrethit te Pejes

Me iniciativen e instruktorve te shkollave fillore shqipe e serbe, e ne marreveshtje me shtabin e pionierve te rrethit si dhe me seksjonin e Sfimit te rrethit te Pejes, para pak ditesh u-zhvillue gara ne mes te njana tjetres nder te gjitha shkollat e rrethit.

Gara e pare u-ba ne shkollen e Gllaviçices, ndermjet kesaj shkolle, Budisalcit, te Nakellit e asaje te Gorazhdevcit; mandej ne Krusheve — ndermjet shkollove: Burane, Krusheve Papraçan, Kotradice Dubovnik. Para se te fillojne garat u-zgjodhen Komisjonet si per shkollat serbe ashtu edhe per ato shqipe. Ma pare u-pytten te gjitha klaset e katerta te çdo shkolle, mandej te tretat, te dytat e ma ne fund edhe te parat.

Gara kufizohej ma teper ne perparimin e nxanesve nder landet e mesimeve dhe njikohsisht edhe ne kualitetin e mesimeve spjegue prej mesuesve. Simbas pytjeve qe ia bane instruktorat pionierve te çdo klase, flamurin kalimtar ne grupin e ndeshjes se pare e fituen pionjeret shqiptar e serb te shkolles se Budisalcit, dhe nji tjeter e fitoi çeta e pionierve shqiptar te shkolles se katundit Nakell. Ne ndeshjen e dyte te grupit tjeter, e fitoi flamurin kalimtar çeta e pionierve te shkolles serbe te Krushevcit, dhe per shkollat shqipe ajo e pionierve te shkolles Papraçan.

Nder keto dite do te bahen gara edhe ne Vitomerice ndermjet shkollave: Vitomerice, Novoselle e Ozrim keshtu qe ma ne fund do te bahet gara e fundit se cila shkolle e rrethit do t'a fitoje flamurin kalimtar per nji vjet ne gjithe rrethin.

Qellimi i ketyne garave asht qe te vehet ne dukje puna e mire ase e dobet e çdo shkolle, e cdo mesuesi, prandaj perfitimi ka me qene mjaft i dukshem per ne vitin e ardhshem shkolluer, sepse nxanesit kane me u-perpjeke te mesojne ma shum njeni se tjetri, dhe mesuesit te japin fryte edhe ma te mira.

Q. O.

Invalidja Mane Syla – ma e mira ne kurset analfabetike te te rejave te Gjakoves

Ne Gjakove, qe ne fillim e deri ne mbarim te njenit prej kurseve analfabetike, te cilin e ka udheheqe nxanesja normaliste Myrvete Qavdarbashi, ndjekset kane kallzue vullnet te mire, keshtu qe edhe perfundimi qe i kenaqe shum. Prej 32 ndjekseve, kater te reja kane dale me perfundim te shkelqyeshem, dhete me perfundim shum te mire, te tjerat me asi te mire, me perjashtim te disave qe nuk e kane ndjeke rregullisht kursin.

Nder te gjitha shqulhej e reja Mane Syla, e cila fatkeqesisht asht invalide ne doren e djathte. Me gjithe ate, ajo ka mesue te shkruej me doren e majte, ka qene ma e rregullta ne kurs dhe gjithmone ma e pregatituna ne mesime nder te gjitha shoqet e veta. Kjo e donte shum udheheqesen e kursit dhe shkonte mire me te gjitha shoqet. Perpiqej vazhdimisht me afrue sa ma shum shoqe te lagjes se vet ne kurs. Perveç kesaj, ajo e don shum perparimin dhe dhe e urren robnin e femnes shqiptare te mbrapambetun. Nji dite kur e pytem na tha: "Un e urrej shum çarshafin qe deri tash mue e shum te tjerave na ka zane frymen, nuk na ka lane te shofim driten e diellit etj.; me gjithe se jam invalide e pak a shum do te me vije turp, do te baj çmos me e zhduke çarshafin-shejin tipik te mbrapambetunis se femnes shqiptare".

Sigurisht, Maneja me vullnetin qe ka, do te perfitoje ma teper ne kursin arsimuer dhe mbrenda pak kohe ka me pase mundesi te siguroje pune ne ndonji sipermarrje ekonomike te qytetit, ase ngjeti, tue e permiresue jeten e vet e te familjes, dhe qe te marre fryme lirisht si shum shoqe te tjera te ndershme perparimtare.

R. KABASHI

Fiskultura dhe Sporti

Sleti fiskultural-manifestim i madh i sukseseve te korruna ne lamen e fiskultures e sportit

Me 13 te ketij muaji mbahet ne Prishtine manifestimi fiskultural. Afer 4000 fiskulturista e fiskulturiste do te manifestojne ket dite fuqin e tyne krijonjese, hovin e tyne rinor, gatshmenin me krye çdo detyr qe shtron para tyne plani i zhvillimit t'one ekonomik, politik e kultural.

Sot, rinija e jone puntore, katundare e intelektuale, krahas me punen qe ban neper sipermarrje, ara e zyra per lulzimin e gjithanshem te Vendit t'one, po ban çmos per edukimin e vet fizik.

Ne Prishtine kane mbrrijte pjesemarresat ne manifestim nga te gjitha anet e Krahines s'one. N'oborrin e gjimnazit te Prishtines u-mbajt mitingu organizativ i fiskulturistave. Sekretari i Bashkimit Fiskultural te Kosmetit, shoku Ramadan Vraniqi, pershendeti fiskulturistat dhe vuni ne dukje randesin e madhe qe ka ky manifestim. Ai tha se rinija dhe populli t'one kane ba hapa te mdhaj perpara ne te gjitha fushat e jetes s'one shoqnore, ekonomike e kulturore. Krahas me ket zhvillim duhet te shkoje edhe fiskultura. Mbasi manifestimi do te jete pasqyre e kjarte e sukseseve t'arrijtuna ne lamen e fiskultures, atehere gjate ditve te llogorimit ne periferin e qytetit te Prishtines kerkohet prej te gjithe fiskulturistave perpjekja ma e madhe per ti stervite sa ma mire ushtrimet e ndryshme me te cilat do te paraqiten. Per t'ia dale kesaj gjaje nevojitet veç perpjekjes, edhe disiplina ma e forte, shembullore.

Mbasandej u-zgjodh shtabi i llogorimit dhe shtaabet e shtate brigadave te fiskulturistave — pjesmarresa te manifestimit. Komandant i pergjithshem i shtabit u-zgjodh Vlado Bohan.

Si deri tash, ashtu edhe kesaj here populli e Krahines s'one presin prej te rijve t'one fiskulturista qe, me perpjekjet e tyne, me hovin e tyne, t'a paraqesin denjesisht perparimin e tyne te gjithaanshem e sidomos perparimin fizik qe asht arrijte gjate tri vjetve te rindertimit dhe ndertimit me plan te Vendit t'one.

Lajme sportive

Shoqnija e te sportive „Polet" nga Prishtina vizitoi te djelen, me 30 Maj Gjakoven. Ketu zhvilloi kater ndeshje miqesore sportive me sportistat e shoqnis „Vllaznija" te Gjakoves: — u-ndeshen ne fotball, basketbol, volibol e shah. Loja e fotballit perfundoi 2:0, ne favaor te „Poletit". Loja e volibolit perfundoi 2:1 ne favor te „Vllaznis". Loja e basketbollit nuk u-zhvillue per arsye teknike.

Ne shah fituen shahistat e „Poletit" 8:4.

Me 7 qershuer, 34 fiskulturista te rij e te reja qe do te representojne Krahinen t'one ne manifestimin fiskultural internacjonal te Prages, u-nisen per Lublan ku do te bajne ushtrime bashke me te gjithe fiskulturistat e Jugosllavis qe marrin pjese ne ket manifestim. Prej kendej mbas 20 ditve do te shkojne ne Prage.

KRONIKA E KRAHINES

Per çdo dite shtohen luftetare te rij per prodhim

PRIZREN:

Rrethi i Prizrenit po fiton luftetare per prodhim ma te madh per dite e ma teper. Ma se 126 bujq jane zotue se do t'i zbatojne te gjitha masat agroteknike ne lidhje me mbjelljet prand verore. Krusha e Madhe ka 72 luftetare qe jane paraqite per me luftue per prodhim ma te madh. Ne Serbicen e eperme jane paraqite 33 e ne Reçan ma se 20 bujq. Te gjithe keta do te punojne simbas udhezimeve t'ekspertave. Ali Ahmeti nga Krusha e Madhe ka çele nji kanal per thamjen e tokes se tij qe e ka nen kenetra. Toka e punueme e Fazli Xhemalit, Ahmet Sulejmanit, Dragi Iliqit e Ramadan Vellsqe te kater nga Krusha e madhe-sherben si shembull per katundaret tjere. Ndue Pjetri, Dushan Bajkiqi e Preng Mikeli jane zotue se tue i perdore masat agroteknike ne pasunit e tyne ne Serbice t'Eperme, do t'a dyfishojne prodhimin e ketij vjeti. Nexhip Asllani e Petko Nikoliqi nga Reçi kane mbjelle miser heterozis dhe e kane shtue siperfaqen e mbjellun me bime industrijale e me bime per ushqim bagtish.

Perdorimi i maqeve agroteknike, te cilat jepen nga Nikolla Sllakoviq, drejtor'i fidanishtes se Prizrenit dhe nga ekspertat tjere, se shpejti do te paraqitet e gjithe massa katundare ne mbare teritorin e ketij rrethi.

R. D.

Hov'i punes ne ndertimin e shtepijave kooperative

PRIZREN:

Ne shumicen e keshillave te vendeve ne rrethin e Prizrenit ka fillue çelja e themeleve te shtepijave kooperative. Ne ket akcjon masovik dallohen frontistat e keshillit te vendit Sredcke, Dushanove e Lubizhde. Kudo neper vendet e rrethit te Prizrenit fillimi i punve bahet me manifestime. Frontistat e katundeve Atmashe, Landovice Nashec, Grazhdanik e Petrove, me rastin e fillimit te shtepis se kooperative jane mbledhe me flamuj e dhurata te ndryeshme tue manifestue dashunin ndaj pushtetin popullor. Ma se 250 frontista muren pjese ne pastrimin e terenit dhe ne çeljen e themeleve.

R. D.

Si priten garat e minjeres Trepça prej puntorve te Goleshit

LIPJAN:

Kolektivi puntuer i minjeres Golesh e priti me enthuzjazem planin e garave te minjeres Trepça. Te gjithe puntoret u-zotuen se do t'i tejkalojne detyrat e parashtrueme. Qysh ne fillim u-korren suksese te papritura.

Smail Muharremi, puntuer i galeris, e ka kapercye normen ne ngarkim 100%, e Shefki Alija punon sa kater te tjere. Ky qet ne nji kohe kater vagonza te plote. Sohmesi Sejdi Osmani, kur ndjen se çka ban shoku i tij, me nji here i shpalli gara. Sejdija punon me tre vagona. Ai shpreson se do t'ia kaloje Shefkiut. Shefkiu zhvillon gara dhe mendon me eksportue me nji here pese vagona te ngarkuem.

Ne pjekjen e mineralit tash jane korre rezultate shembullore gjate historis se kesaj minjere. Osman Beqiri, Isa Mehmeti e Riza Fejzullau punen e pese ditve e kane krye per tri dite.

Permiresim'i kushteve te jeteses per puntoret e Goleshit

GOLESH:

Banesat dhe ushqimi i puntorve te minjeres Golesh po permiresohet gjithnji ma teper. Puntoret fitojne sasina te mjaftueshme mishi ne saje te fregtis se mire me çmime te lirdhuna. Minjera e ka fitue dhe punue ekonomin e saje prej 114 ha. toke.

Keto dite marrin fund dy ndertesa moderne per banim. Ne keto do te vendosen pese familje te mdhaja te puntorve. Çdo banese ka nga pese dhoma.

Formimi i çetave te punes

PRIZREN

Keshilli i Frontit Popullor per qytetin e Prizrenit ka formue 20 çeta puntore me 1200 frontista. Keto çeta kane fillue punen dhe po meremetojne rruget e Prizrenit dhe ndermjet qytetit e katundeve t'aferme. Kater prej ketyne çetave nuk kane personelin udheheqes: udheheqesin kulturo-arsimuer, ate profesjonal dhe evidentistin.

Aktivitet i gjithanshem i grave antifashiste te Mitrovices

MITROVICE:

Fronti Antifashist i grave te Mitrovices zhvillon nji veprimtari te madhe politiko-masovike e kulturo-arsimore.

Ne 20 grupe lexími jane perfshi 1080 gra, prej te cilave 340 jane shqiptare. Aktivat e agitatoreve veprojne me hov; spjegojne randesin e akcjoneve te tyne dhe per çdo te mertmene mbajne mbledhje edukative, ku perpunohen dekret-ligjet, lajmet e udheheqsave dhe artikuj nga shtypi. Prane keshillit te qytetit egziston aktivi i agitatoreve, i perbame prej 34 shqiptareve. Me aktivat e agitatoreve jane mbajte dy seminare, e me udheheqeset e grupeve te lexímit asht mbajte nji konsulte ne lidhje me çashtjen e permiresimit te punes.

Ne muejin e ardhshem do te mbahet kursi per kujdestare. Kursin do t'a udheheqin dy mjeke, nji mami e nji mesuese.

Pese gra jane dekorue me medaljen e Frontit per pune te vetmohueshme. Nder keto jane edhe Rukije Ceni e Zenuha Selimi. Fronti i grave te Mitrovices asht shperblye per aktivitetin dhe perpjekjet e tij me 20.000 dinare, nga Keshilli Kryesuer i FAG-es per Serbi.

Grate e Mitrovices kane marre pjese masovike ne pastrimin e drithnave prej barnave te damshme, ne rregullimin e shtepis se kultures dhe ne ndertimin e shtepis se sindikatit. Ne kopshtin e shtepis se femijve, grate e Mitrovices kane mbjelle 50 kg. budra. Prej kallndorit deri ne maj kane punue 86 fanella per femijt e vorfen. Pune te madhe japin rreth arritimit te teshave te femijve te vorfen dhe neper kuzhinat e nxansve t'pilernadeve. Ne keto dhe ne te gjitha akcjonet tjera qe ka organizue Fronti, grate e Mitrovices kane dhane ma se 4000 ore pune vullnetare.

Festival kangesh e vallesh

MITROVICE:

Ne Mitrovice u-mbajt festivali i kangeve, valleve dhe zakoneve popullore. Muaren pjese grupe te ndryshme te billoqeve te Mitrovices, shoqnija kulturo-artistike shqiptare dhe shoqnija "Trepça e Zvecanit.

Ndigjoni emisijonet ne gjuhen shqipe

RADIO PRISHTINA

me vale te mesme 283 metra

Cdo dite n'oren 18.30 — lajme nga Kosmeti;
Cdo dite n'oren 19.30 — Permbledhje e shtypit;
Te hanen, merkuren e te premten n'oren 20-ora e arsimit popolluer;
Te marten n'oren 20-"Nga Bashkimi Sovjetik";
T'ejten n'oren 20 kronike kulturore;
Te shtunden n'oren 20.30-kronika e ngjarjeve politike te javes;
Te djelen n'oren 20-emisjoni per femij.

RADIO BEOGRAD

Lajme ne gjuhen shqipe transmeton dy here ne dite:
n'oren 14,45 me vale te shkurta 31,56 metra dhe
n'oren 17,15 me vale te shkurta 58,18 metra.

10 Qershuer 1948

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Vdekje Fashizmit — Liri Popullit!

„Rilindja" fletore e perjavshme. Redakcija: Rruga Emin Duraku Nr. 1 — Prishtine. Pajtimet i pranon Administrata dhe ekspedicioni „Rilindja". Numri i çekut 38 — 90-60-30.
Taksa postale e pagueme

Massat punonjese e priten me enthuziazem 'mbylljen e tregtoreve private

Ne serin e masave qe ka marre Qeverija qendrore me qellim te likuidimit te te gjitha pengesave ne rrugen e ndertimit t'one socjalist, vend te randesishem zen edhe Dekreti Ligji mbi mbylljen e dyqaneve private ne Vendin t'one. Tregtija private gjithmone ka qene mjeti ma i forte i kapitalizmit per çfrytezimin e masave te gjana punonjese dhe per grumbullimin e profiteve ne kurriz te popullit. Tregtija private, si e ketille ka paraqite nji pengese te madhe per zhvillimin t'one socjalist, sepse nga nji ane, njerzit t'one punonjes detyroheshin me ble shum shtrejte gjane te ndryshme, e nga ana tjeter, tregtaret privat kane qene kjo qender per mashtrimin e njerzve t'one, per mos me ja shite mallnat tregtis shtetnore dhe asaj kooperative. Pra, nen kushtet t'ona, tregtija private ka qene qendra e spekulimit te paligjeshem, qendra e sabotimit ekonomik dhe e vazhimja degë e çfrytezimit te masave.

Jane mbylle deri tash ma teper se 800 dyqane private ne Krahinen t'one. Ndi ne te gjitha keto jane gjete mapma te ndryshme spekulimi. Per shembull ke tregtaret e Prizrenit Cvetko Milenkoviq, Shefqet Lleshi, Isak Tetaku etj. jane gjete sasina te madhaja bezi, ari, argjenti, likure te shtrejte e gjanash tjera te çmueshme. Vlera e ketyne mallnave te gjetuna kalon shumen e 50 miljona dinarve. Ke tregtari Isak Tetaku, veç 840 metrave bez, jane gjete edhe sasina te madhaja paresh te Shqipnis dhe te Jugosllavis. Ke Shefqet Lleshi asht gjete nji killogram flori, 3 killogram argjent dhe 934 copa likura te ndryshme. Ke kafexhiu Dalip Ahmeti, ne Podujeve, jane gjete 60 killogram oriz te mshefun, e ke tregtari Shamid Xhelalini ne Kaçanik 12.000 killogram krype. Edhe ndur tregtaret e Prishtines jane gjete sasina te madha ja mallnash te ndryshme; dallohen si spekulanta te zbulaem me ket rast Ruben Mihailo, Arangjel Jovanoviq, Pera Liliq etj.

Populli punonjes i Krahines s'one e pershendete me enthuziazem ket mase te pushtetit popullor, si hap te madh te permiresimit te standardit jetesuar te masave punonjese.

T'i luftojme zakonet mbrapanike

Si p'a'u don te kthehe per grue te trde te fejuemen e nipit te tij vajzen 16 vjeçare

Te na ende spikate edhe te kthyemit e mases ke njeni prej mashkujve te shtepis, kur asaj i vdes i shoqi ase i fejuemi, pa marre parasyshe mosha e tij-qofte teper i ri, ase plak.

Nji shembull te ketille e kemi ne katundin Ponoshec te rrethit te Gjakoves: Idriz Rama, burr'i vjeter 60 vjeçe, i martuem dy here, tue i pase ne shtepin e vet te dyja grate, me rastin e vdekjes se nipit te tij, ka vendose me e kthye te fejuemen e atij, vajzen 16 vjeçare Ryva Ramen. Kjo, me te marre vesht ket lajm t'idhet, ka fillue te dobesohet nga shendeti dhe ka ra ne pike te hallit. E ama e saje, po ashtu, ka ra ne hall se si me ia ba. Ryva asht vajze e zgjuet, ka mesue mire dhe ka krye me sukses kursin analfabetik. Kur aje jepte provimin shpreheJ keshtu: "Jam e gatshme te mesoje edhe ma shum, te punoje kudo qe te jete ma e nevojshme, por vetem e vetem qe te shlirohem nga burri plak, me te cilin asgja s'me bashkon.

Nuk duhet te lejojme kurr qe jeta e nji vajze, e cila premtun shum per shoqnin t'one, sidomos nder katunde, te shuhet per hiq te nji adeti mbrapanik; na duhet t'i apim nji here e mire shpejtnin kalbesimes te traditeve nga terri i kaluem dhe te vazhdojme rrugen e mbare qe e kemi nise.

M. QAFDARBASHI

Nga situata nderkombtare

Kujt i bjen pergjegjsija per mosmarreveshtjet ne mes te BRSS e SH. B. A.

Pergjithsisht, qarqet sunduese te SH.B.A. ne shpalljen e deklarates t'ambasadorit amerikan Smit, si dhe ne letren e Vallasit dhe ne pergjegjen e Stalinit, e kane tregue veten se ato nuk e duen aspak rregullimin e mosmarreveshtjeve te tashme dhe se ato nuk kane kurrkaj besupe qe t'a marrin vesh opinjoni publik botnuer se kujt i bjen pergjegjsija per situaten e veshtire ne bote. Me rastin e deklarates se fundit, me 19 maj, ne te cilen ministrija amerikane e punve te jashteme ka vue 11 pika mbi problemat qe jane shkak i mosmarreveshtjeve ne mes te Sh.B.A. e B.R.S.S., agjensija TASS e dha me 22 maj nji komunikate, ne te cilen paraqitet pikpamja e qarqeve udheheqse sovjetike mbi ato pika kundershtuese.

Ne Komunikaten e Tassit thuhet se vendimi i Kombeve te Bashkuem mbi pakesimin e armatimeve nuk ekzekutohet, para se gjithash, sepse qeverija e SH.B.A. ka marre nji qendrim kunder atij vendimi. Qeverija e Sh.B.A. e zbaton politiken e armatimit gjithnji ma te madh, tue shpenzue per ate qellim shum miljarda dollare. Po ashtu, ndersa Bashkimi Sovjetik asht per ndalimin e rrepte t'armes atomike, si mjet per çfarosjen, ne rend te pare te popullsis civile, dhe ndersa ai perpiqet qe energjija atomike te perdoret vetem per qellime paqsore, qeverija e Sh.B.A. e bane tane pergjegjsin qe deri tash nuk asht marre vendimi mbi ndalimin e armes atomike.

Persa i perket lidhjes se paqes me Austrin, ne komunikate thuhet se qeverija amerikane nuk i permbahet vendimeve te marruna ne konferencat e Jaltes e te Potsdamit, por perkundrazi i refuzon te gjitha propozimet e qeveris sovjetike per rregullimin e ketij problemi. Qeverija amerikane, jo vetem se nuk i permbushe vendimet mbi demilitarizimin e demokratizimin e Gjermanis, gja qe asht nji nga kushtet ma te randesishem per mbrojtjen e paqes dhe te sigurimit n'Europe, por mbeshtetet ne fuqit reakcjonare gjermane, te cilat ne te kaluemen kane sherbye si mbeshtetje e hitlerizmit, dhe marrin pjese ne rimekambjen e fuqis luftarako-ekonomike te Gjermanis.

Po keshtu qendron edhe puna me traktatin e paqes me Japonin. Ne kundershtim me marreveshtjen e Potsdamit, qeverija amerikane asht kundra pregaditjes se traktatit te paqes ne Keshillin e ministrave te punve te jashtme dhe kundra terhjekjes se trupave okupuese. Njikohsisht, Sh. B. A. u ndihmojne qarqeve agresive per me rimekambe fuqin ushtarako-ekonomike te Japonis, tue damtue ne kete menyre çeshtjen e paqes.

Persa i perket terhjekjes se trupave nga Kina, Bashkimi Sovjetik e ka permbushe qysh me kohe obligimin dhe i ka terhjeke njisite e veta ushtarake nga Kina, siç ka qene vendose ne muejin dhetuer 1945 ne konsultimin e ministrave te punve te jashtme, ne Moske. Me gjith'ate, njisit ushtarake amerikane ende edhe sot ndodhen ne territorin e Kines, gja kjo qe ka kontribue ne zgjanimin e luftes civile ne Kine.

Me masat e saje antidemokratike dhe me dhanjen ndihme grupeve reakcjonare te Kores, komanda e trupave amerikane ne Kore, e ka ba te pa-mundshem zbatimin e marreveshtjes mbi vendosjen e Kores si shtet i pamvarun. Po ashtu, qeverija amerikane ka refuzue propozimin sovjetik mbi terhjekjen e menjikohesme te trupave sovjetike e amerikane nga Koreja, per me i u dhane mundesija popullit te Kores qe te vendose vet mbi problemat e tij te mbrendeshme.

Politika dhe veprimtarija e qeveris amerikane, ne kohen e fundit, kane dhane shembuj te pa-numurt te perzimjes se Sh. B. A. ne çeshtjet e mbrendeshme te vendeve te tjera dhe te cenimit te sovranitetit te tyne shtetnore. Shtetet e Bashkueme t'Amerikes e kane shendrrrue Greqin ne bazen e tyne ushtarake dhe i ndihmojne fashistat grek ne çfarosjen e popullit grek. Dihet po ashtu edhe perzimja e Sh. B. A. ne punet e mbrendeshme t'Italis ne lidhje me votimet e 18 prillit te ketij vjeti, gja qe u-shpreh ne presjonin ekonomik e politik, ne dergimin e anijeve luftarake amerikane ne n'ujnat italjane etj.

Ne komunikate thuhet se ekzistimi i bazave ushtarake amerikane ne territorin e vendeve te tjera nuk mund te justifikohet mbas mbarimit te luftes dhe ai nuk asht ne pajtim me parimet themeltare t'Organizates se Kombeve te Bashkuem.

Me rastin e deklarates se ministris amerikane te punve te jashtme se Sh. B. A. u japin ndihma shteteve te tjera, dhe kete ndihme e japin jashtë anen e Organizates se Kombeve te Bashkuem, ne komunikate thuhet se e ashtu-quejtuna ndihme amerikane disa vendeve u jepet ne menyre te njaneshme, pa e marre aspak parasyshe Organizaten e Kombeve te Bashkuem dhe se UNRA asht likuidue me inisjativen e Sh. B. A. Po ashtu, qeverija amerikane e ka refuzue propozimin e BRSS ne Keshillin e sigurimit, qe ndihma Greqis te jepet vetem n'interesin e popullit grek dhe nen mbikqyrjen e Komisjonit te Keshillit te Sigurimit. Qarqet sunduese te Sh. B. A. e perdorin ndihmen per vendet e tjera per me pase vet mbikqyrjen politike e tjera, ne gjithe Organizata e Kombeve te Bashkuem e ka cilsue nji veprim te ketille se te papranueshem.

Mbi çashtjen e demokracis dhe te lirive qytetare, qarqet sunduese te Sh. B. A. nuk tregojne kurrfare kujdesimi per mbrojtjen e ketyne, por i ruejne dhe i imponojne regjimet reakcjonare e fashiste ne vendet e tjera, si ne Greqi, Spanje, Iran etj., ndersa Bashkimi Sovjetik insiston qe demokracija dhe lirit qytetare t'a gezojne mbrojtjen ne te gjitha vendet.

Ne fund te komunikates thuhet se asht e kjarte kujt i bjen pergjegjsija per gjendjen e tashme te marredhanjeve sovjeto-amerikane. Per derisa qeverija amerikane nuk i respekton vendimet ne Teheran, Jalte e Potsdam, derisa ajo e len mbas shpine Karten e parimet e Kombeve te Bashkuem, asht e kuptueshme se nji qendrim i ketille nuk mund te kontribuoje ne perparimin e marredhanjeve nderkombetare. (Tanjug)

Lajme te shkurta

ROME:

Siç lajmeron agensija Frans-pres, ne Lombardin e jugut dhe ne provincen e Bolonjes, mbretnon pa kenaqsi e madhe per shkak te sulmeve te policis mbi puntoret bujqe te cilet ndodhen ne greve te pergjithshme per shkak t'ardhuese policore, sipas te cilave ndalohen mbledhjet publike e demostratat. Tue ia pergjegje thirrjes te Dhomes puntore ne Bolonje, te gjithe puntoret e nepunsat e provinces se Bolonjes e shpallen greve e pergjithshme protestuese. Puna asht ndalue ne mbare provincen. Ne shej rapresalje kundra grevistave, pushteti policuer i ndaloi te gjitha mbledhjet e kollonat e, neper rruget qarkullojne karrot e blindueme me aradhe t'armatosuna policore.

Fitorja e madhe e popujve te Çekosllovakis

Ne votimet per Kuvendin Popullor te Republikes se Çekosllovakis, te cilat u-mbajten me 30 maj te ketij fejeti, forcat demokratike korren edhe nji fitore shum te madhe. Votimet qene manifestim i fitores, vendosmenis dhe bashkimit te masave popullore te Çekosllovakis. Kto votime shenuen perfundimin ngadhnimtar te nji periudhe te luftes se tyne, luftes se forcave demokratike te Çekosllovakis kundra reakcjonit te mbrendshem e te jashtem, per paqe, per zhvillimin demokratik popullor dhe per socjalizem. Fronti Popullor i Çekve dhe Sllovakve, i rilindun dhe i spastruem prej elementave antipopullor, tash u-ba shprehje besnike e bashkimit te popullit, i kili — me gjithe germadhjet e mdhaja te reakcjonarve — asht ndertue dhe forcue nga poshte, ne masat e gjana popullore. Per listen unike te Frontit Popullor kane votue 89,3% te votuesave. Kjo vertetton se populli çekosllovak ka zgjedhe rrugen e perspektivave te ndritshme — rrugen e bashkimit te çekve e sllovakve, rrugen e perbashket me popujt vllazen sllave dhe me te gjithe popujt tjere demokratik te botes, — rrugen e paqes, punes krijonjese dhe jetes ma te mire — rrugen kah Socjalizmi.

Votimet ne Çekosllovaki jane nji kthese e popullit çek e sllovak, i cili, mbassi siguroi bashkimin shtetnuer e popullor, tash do te jape te gjitha forcat per ndertimin e ardhmenis. Kjo fitore e madhe asht baza e sigurte per zhvillimin shoqnuer e ekonomik te vendit dhe forcim i pozites e sigurís nderkombetare, asht pergjegja e sterte per çofiat dhe armiqet e Çekosllovakis demokratike popullore.

Gjendja ekonomike ne Greqi

Nuk asht nevoja qe na te bajme fjale mbi kete, sepse paraashtrimi i drejtorit te s'ashtu quejtunes Banke popullore n'Athine, Pezmedzhogllu, asht teper i kjarte: „Ne vjetin 1947 prodhimi i drithnave asht pakesue me 26%, e niveli i pergjithshem i prodhimit nemzi i mberrine 65% t'atij te paraluftes. Hyrja e çmimeve, ne fundin e vjetit te kalupem, ka qene kaq e madhe sa ekziston edhe ma tutje rreziku i nji situate kritike qe nuk ka dolje".

Veçanerisht, i veshtire asht problemi i papunesis. Fabrikat e sipermarrjet mbyllen njena mbas tjetres, e bashke me kete edhe papunesija rritet gjithnji ma teper. Bizniesmenet amerikane ne vrapin e tyne per profite, bajne çmos qe keto probleme t'i veshtiresojne sa ma teper. Kane refuzue me eksportue ne Greqi kundet e para dhe dergojne vetem prodhime te gateshme industrijale. Keshtu p.sh., refuzojne me eksportue grurin, por ne vend te ketij eksportojne miellin, makaronat etj., kurse mullijt e industrija e pastave ne Greqi e pushojne punen, dhe puntoret mbeten ne rruge. Keshtu ngjet edhe me prodhimet metalike, me ato te gomes, si dhe me industrin e tjeranit, kurse per Greqin prodhimet e duhanit perfaqsojne eksportimin e saje kryesuer.

Grumbujt e miljona dollareve qe jane caktue si "ndihme" per Greqin, nuk jane ne gjendje me e sulreqe gjendjen ekonomike te saje, per me ndalue inflacjonin qe ka shkue shum thelle dhe t'a mjekojne financen greke. Dhe kjo asht edhe e kuptueshme, sepse ata miljona dollare, ne pjesen ma te madhe, vijne ne pamjen e armeve, diçka ne mallna te gateshme industrijale, e kurgja per rindertimin. Ungarija asht e shtrueme kjartet imperjalistat amerikane per me fitue edhe nji baze ushtarake per planet e veta grabitçore dergojne arme me shumice, e populli grek te te pritet e te sakatohet. Por, puna asht pune, e ata nuk japin kurgja falas. Keto dergesa ata i nxjerrin nga taksat e ndryshme qe i paguen populli amerikan, por njikohesisht, ata e debitojne popullin grek.

Gjenerali Grizvold, per me e mbajte zhag si te mundei katastrofen financjare, u ditu urdhen rrogtareve te vet t'Athines qe te leshojne nga puna nji numer te madh nepunsash shtetnore, dhe ata i leshuen. (Tanjug)

Situata ne Palestine

TEL AVIV: 5 Qershuer.

Radjo stacjoni "Zani i Izraelit" lajmeroi se dje kater anije luftarake egjyptjane tentuen me iu afrue bregdetit n'aferi te Tel-Aviv-it. Njisit e flotes se Shtetit Izraelit, te ndihmueme prej baterive breg-detare, kryen nji sulm te fuqishem mbi anijet luftarake egjyptjane. Luftimi zgjati ma se tri ore, dhe n'ate rast nji anije luftarake egjyptjane u-godit rande e, te tjerat u-damtuen.

Luftimet per toke vijuen dje gjate tane dites ne te gjitha frontet. Ne komunikaten e fuqive t'armatosuna t'Irakut lajmerohet se trupat irakjane bajne operacjone te gjana ofensive ne sektorin Veri-lindor te Tel Aviv-it Luftime t'ashpra bahen ne pikat e fortifikueme 12 kilometra afer Tel Aviv-it. Trupat irakjane po ashtu sulmojne edhe ne sektorin ne mes te qyteteve Xhenim e Afuda, si dhe ne sektorin e qyteteve Petah-Tikvah, ne ve sprendim te Tulkarm-es.

Ne komunikaten e Haganes lajmerohet se mbas luftimesh t'ashpra, fuqit çifute mujten me depertue ne qytetin Xhenin, ku po bahen luftime shpi per shpi, dhe ku artilerija çifute i godite pa pra pozitat e fortifikueme arabe ne qytet.

Lajmerohet po ashtu se fuqit çifute i kane rrethue pjeset e shpernjame te fuqive egjyptjane afer Irduhit, 32 kilometra ne jug te Tel Aviv-it. Avijacjoni çifut ka krye me sukses nji seri sulmesh ne perqindrimet e trupave arabe ne te gjitha sektoret e frontit ne Palestine.

VARSHAVE:

Tass lajmeron:

Me 29 maj u-nenshkrue ne Varshave Pakti mbi miqsine, bashkpunimin e ndihmen reciproke ne mes te Republikes Polonez e Republikes Popullore te Bullgaris. Paktin e nenshkruen n'emen te Polonis-Kryetari i Keshillit Ministruer Juzef Cirankjeviq e ministri i punve te jashteme Modzelevski, dhe n'emen te Bullgaris-kryetari i Keshillit ministruer Giorgi Dimitrov e nenkryetari i qeveris dhe ministri i punve te jashteme Vasil Kollarov.

HELSINKI:

Tass lajmeron:

Simbas shenimit te gazetave te kryeqytetit finlandez, pakesimi i damshperblimeve te luftes qe duhet t'i paguej Finlanda BRSS-it arrine n'afer 70 miljone dollare.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Shtypshkruja Krahinore e Frontit Popullor Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.